



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0252

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së OE MESE PHARM SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “013 Furnizim me barna dhe material shpenzues mjeksore për barnatoren qendrore pran QKMF-se për plotesimin e mungesave me furnizim nga lista esenciale” me numër të prokurimit 635-25-2045-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES, më 12.06.2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishtë e bazuar ankesa e MESE PHARM SH.P.K., me nr. 2025/0252, e datës 08.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “013 Furnizim me barna dhe material shpenzues mjeksore për barnatoren qendrore pran QKMF-se për plotesimin e mungesave me furnizim nga lista esenciale” me numër të prokurimit 635-25-2045-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës.
2. Anulohet, Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “013 Furnizim me barna dhe material shpenzues mjeksore për barnatoren qendrore pran QKMF-se për plotesimin e mungesave me furnizim nga lista esenciale” me numër të prokurimit 635-25-2045-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Me qen se ankesa aprovohet si pjesërishtë e bazuar, OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.03.2025, Komuna e Pejes., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “013 Furnizim me barna dhe material shpenzues mjeksore per barnatoren qendrore pran QKMF-se për plotësimin e mungesave me furnizim nga lista esenciale” me numër të prokurimit 635-25-2045-1-1-1.

Autoriteti Kontraktues në këtë rast ka zhvilluar procedurë të hapur të prokurimit lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 162,272.00 €.

Me 02.04.2025, OE MESE PHARM SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 03.04.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE MESE PHARM SH.P.K., me nr. 2025/0252 lidhur me aktivitetin “013 Furnizim me barna dhe material shpenzues mjeksore per barnatoren qendrore pran QKMF-se për plotësimin e mungesave me furnizim nga lista esenciale” me numër të prokurimit 635-25-2045-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga Operatori Ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Komuna e Pejes., janë parashtruar si në vijim:

Sa i përket Iso certifikatave ne konsiderojmë se këto Iso nuk janë në harmoni me natyrën e këtij tenderi.

Certifikata 9001:2015 ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të cilësisë për organizatat e ndryshme.

Certifikata 13485:2016 ka të bëjnë me sistemin e menaxhimit të cilësisë për pajisje mjekësore për prodhues, e jo për furnizime me barna dhe material shpenzues.

Për këtë Iso edhe vetë AK-së e ka cekur dhe pranuar se ka të bëjë për pajisje mjekësore, ndërsa në këtë tender nuk ka furnizim me pajisje mjekësore, gjë që dëshmohet se është e panevojshme.

Certifikata 14001:2015 ka të bëjë me standardet ndërkombëtare për sistemin e menaxhimit mjedisor. Arsyeimi i AK-së është jo profesional që është dhënë me sqarime, pasi që menaxhimi i mbetjeve farmaceutike është pjesë tjetër e funksionimit dhe në këtë rast nuk kemi të bëjmë me mbetje farmaceutike. Asgjësimi i mbetjeve farmaceutike është procedurë tjetër dhe nuk ka të bëjë fare me këtë pjesë.

Certifikata 45001 2018 nuk ka te beje me furnizim me barna dhe material shpenzues por ka të bëjë me sigurinë në punë, e që realisht nuk ka fare rëndësi për autoritetin kontraktues a kujdesen kompanitë për sigurinë në punë tek organizatat e tyre, sepse këto janë pjesë tjera të legjislacionit dhe të drejtave e obligimeve.

Sa i përket kushteve të sigurta që e ka përmend AK-së tek sqarimet shitesë, sqarojmë se depot ku ruhen barnat e materialet janë të licencuara, prandaj kjo Iso nuk ka të bëjë fare me këtë çështje.

Këto certifikata nuk kanë të bëjnë fare me këtë aktivitet të prokurimit, prandaj kërkojmë që të largohen nga kërkesat e dosje së tenderit si të panevojshme. Këto certifikata vetëm favorizojnë kompani të caktuara ndërsa në realitet nuk kanë asnjë rëndësi apo impakt në këtë tender me furnizim me barna dhe material shpenzues.

Autoriteti kontraktues i ka ndryshuar njësitë e pozicioneve 22,23,24,25,26 dhe 51 mirëpo nuk ka ndryshuar njësinë për pozicionin 20 dhe 21 që ka të bëjë me dorëza, prandaj kërkojmë që edhe ky ndryshim të bëhet me qëllim të efikasitetit të procedurës.

Ne Aktivitetin e prokurimit te vitit 2022 nga Komuna Peje, Nr i prokurimit: 635-22-3645-1-2-1, Titulli: Furnizim me material shpenzues - barna për barnatorën qendrore të QKMF-së, kane qene te kërkuara:

Doreza jo sterile S,M,L puder free 1/100 360 Pako per 24muaj

Ndersa tani kërkohen 48000 pako per 12 muaj.

Sasia e paraparë për dorezat josterile Medium dhe Large, përkatësisht nga 24,000 pako secila (që përkethehet në gjithsej 4,800,000 copë doreza), është jashtëzakonisht e lartë dhe tejkalon ndjeshëm nevojat reale vjetore të institucionit. Duke marrë parasysh çmimet aktuale të tregut, kjo sasi përfaqëson një vlerë shumë të lartë, e cila vetëm për doreza arrin shumën prej 144,000 €, apo shumica e buxhetit të parashikuar të projektit, nëse llogaritet vetëm për këto dy pozicione.

Në këtë rast kuptohet qarte një disproporcion i madh në ndarjen e buxhetit, ku pjesa më e madhe e mjeteve financiare do të shpenzohej vetëm për një kategori produktesh – gjë që cenon qëllimin dhe balancën e projektit në tërësi.

Për këtë arsye Kërkojmë që njësia e matjes të ndryshohet nga “Pako” në “Copë” ose Sasia e kërkuar të rishqyrtohet dhe reduktohet, në mënyrë që të përputhet me nevojat reale vjetore dhe të mos ndikojë negativisht në pjesën tjetër të furnizimit të projektit. Ky ndryshim është i domosdoshëm për të ruajtur proporcionalitetin e projektit dhe për të mundësuar pjesëmarrje të barabartë dhe të drejtë të operatorëve ekonomikë në procesin e ofertimit.

Nese eventualisht nuk merren parasysh kerkesat tona atehere AK-ja eshte e detyruar te rrit vleren e parashikuar edhe per 140000 mije euro pasi qe kontrata per nje aktivitet i tille nuk mund te permbushet sipas specifikimeve dhe listes se cmimve te percaktuar nga AK.

Duke marrë parasysh të gjitha argumentet e lartcekura, kërkojmë që kërkesa për posedimin e mjeteve të përmendura më lartë të largohet nga dosja e tenderit, pasi që e njëjta nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e këtij prokurimi dhe vetëm kufizon konkurrencën në mënyrë të paarsyeshme.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik "MESE PHARM SH.P.K.", me datë 02.04.2025, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:

Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësorë për barnatoren qendrore pran QKMF-se për plotesimin e mungesave me furnizim nga lista esenciale, me Nr. të Prokurimit:635-25-2045-1-1-1.

Autoriteti Kontraktues, me datë 03.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

A.K., pas analizës së kërkesës suaj për ri-shqyrtim dhe duke marrë për bazë kërkesën tuaj në platformën elektronike të datës 01.04.2025, e ka trajtuar me kujdes dhe ka ardhur në përfundim se e njëjta është e pa bazuar.

Në lidhje me kërkesën tuaj për ri-shqyrtim, të paraqitur më datë 02.04.2025, Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar me kujdes pretendimet tuaja dhe ju njofton si më poshtë:

Certifikatat ISO të vendosura në Fletën e të Dhënave Teknike (FDT) janë në përputhje me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke qenë se operatorët ekonomikë duhet të jenë të certifikuar sipas standardeve ISO, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

Këto certifikime sigurojnë që furnizimet janë në përputhje me standardet evropiane, si dhe që kompania operon në përputhje me standardet dhe kriteret e kërkuara për të garantuar furnizimin me produkte cilësore për Autoritetin Kontraktues.

Për sa i përket pretendimeve tuaja lidhur me pozicionin 20: "Doreza josterile Medium (1x100 copë)" dhe pozicionin 21: "Doreza josterile Large (1x100 copë)", sqarojmë se këto janë të specifikuar në dokumentet e tenderit, në përputhje me kërkesat e njësisë kërkuese. Ky formulim është bërë për të garantuar saktësinë dhe përputhshmërinë me nevojat e institucionit.

Bazuar në sa më sipër, kriteret e përcaktuara janë në përputhje me LPP-në dhe Rregulloren për Rregullat dhe Procedurat e Prokurimit Publik (RrPP).

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0252/2025, ndërsa me datë 16.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0252 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, "Autoriteti kontraktues nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues. Ndërsa OE është pajtuar rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE MESE PHARM SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0252 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi ankimor nr. 1 i Operatorit Ekonomik lidhur me kërkesat për certifikata ISO në tenderin me titull: “Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor për barnatoren qendrore pranë QKMF-së për plotësimin e mungesave me furnizim nga lista esenciale.” Konkretisht me Kërkesa 4 .Operatori ekonomik te ofroj Certifikata ISO :

-ISO 9001 2015- Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë

-ISO 14001 2015– Sistemi i Menaxhimit Mjedisor

-ISO 45001 2018 - Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

-ISO 13485 2016 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1:

Eksperti shqyrtues ka analizuar në mënyrë të hollësishme pretendimin ankimor me pikat e trajtuara duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura nga Autoriteti Kontraktues dhe në pajtim të plotë me legjislacionin përcaktues në fuqi, ku ndër të tjera eksperti e ka trajtuar secilën pikë të kontestuar nga OE ankues si:

Vlerësimi i kërkesave për ISO standarde:

ISO 9001:2015 – Menaxhimi i Cilësisë-E justifikueshme dhe relevante për natyrën e kontratës. Rekomandohet të mbetet si kriter kualifikues.

ISO 14001:2015 – Menaxhimi Mjedisor-Jo relevante për furnizim të barnave; e zakonshme për sektorë me ndikim në mjedis (ndërtim, prodhim). Rekomandohet të hiqet.

ISO 45001:2018 – Shëndeti dhe Siguria në Punë-E pajustifikueshme për OE që merren vetëm me furnizim/shpërndarje; aplikohet në sektorë me rrezik fizik të lartë Rekomandohet të hiqet.

ISO 13485:2016 – Cilësia për Pajisje Mjekësore

Relevante vetëm nëse kontrata përfshin pajisje mjekësore. – Meqenëse sipas përshkrimit të titullit të aktivitetit dhe para masës dhe para llogaris shihet se kjo kontratë ka të bëjë me furnizim me barna dhe me material shpenzues andaj rekomandohet të hiqet kjo kërkesa.

Bazuar ne sqarimet e paraqitura me lart eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor nr.2 i Operatorit Ekonomik eshte se sasia e kërkuar për pozicionin 20 dhe 21 (doreza jo-sterile Medium dhe Large, nga 24,000 pako secila), për të cilën Operator Ekonomik pretendon se është e tepruar dhe joreale, duke ndikuar në disbalancimin buxhetor të projektit dhe kufizimin e konkurrencës.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor Nr. 2

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin në lidhje me sasi të kërkuara për pozicionet 20 dhe 21. Sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), njësi kërkuese është përgjegjëse për përcaktimin e saktë të nevojave dhe sasisë, duke u bazuar në analiza reale të përdorimit dhe konsumit vjetor.

Nuk është e mundur të konstatohet në mënyrë të sigurt nëse sasia prej 24,000 pakosh për secilën lloj është e tepruar apo e justifikuar, pa një analizë të detajuar të nevojave operative dhe të dhënave të konsumit të mëparshëm. Po ashtu, nuk mund të thuhet se ka tejkalim apo manipulim të qëllimshëm pa pasur prova konkrete që e mbështesin një pretendim të tillë.

Megjithatë, duke marrë parasysh shqetësimin e Operatorit Ekonomik për proporcionalitetin dhe ndikimin në konkurrencë, rekomandohet që Autoriteti Kontraktues, përmes njësisë kërkuese, të bëjë një rivlerësim të brendshëm të nevojave. Nëse pas këtij rivlerësimi rezulton se sasia është e arsyeshme dhe në përputhje me nevojat operative, ajo mund të mbetet e pandryshuar.

Bazuar ne sqarimet e paraqitura me lart eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkrësive të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka

vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “013 Furnizim me barna dhe material shpenzues mjeksore per barnatoren qendrore pran QKMF-se për plotësimin e mungesave me furnizim nga lista esenciale” me numër të prokurimit 635-25-2045-1-1-1.

Paneli Shqyrtues e mbështet pjesërisht raportin e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor 01 lidhur me certifikatat e kërkuara ISO sikurse përcaktohen në nenin 70 të LPP-se .- ISO 9001 2015- Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë , për PSH është e pranueshme lidhur me natyrën e këtij aktivitet të prokurimit, andaj konstatimi i eksperti shqyrtues është i pranueshëm.-ISO 14001 2015– Sistemi i Menaxhimit Mjedisor konsiderohet se është i pranishëm , ngase duke marrë për bazë afatin kohor për implementimin e kontratës prej 12 muaj kalendarik dhe vlerën e parashikuar të kontratës , lidhur me furnizimet sikurse ky aktivitet dhe kur ka të bëjë me shëndetin publik dhe kur dihet se furnizimet nuk mirën aty për aty dhe bëhet tek barnatoret qendrore që do ti përcakton AK-ja , OE-të në rastë se nuk posedojnë një certifikat të tillë mund të lidhin marrëveshje konzercium sikurse parashihet në nenin 71 të LPP-së.. -ISO 45001 2018 - Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, mbështes konstatimin e ekspertit shqyrtues ngase kjo certifikat kryesisht kërkohet për tu mundësuar të ofrojnë vende pune të sigurt dhe të shëndetshme, andaj kjo procedur ka të bëjë vetëm me furnizim/ shpërndarje. -ISO 13485 2016 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore, konstatimi i ekspertit shqyrtues është i pranueshëm.

Lidhur me pretendimin ankimor nr.2 . Paneli Shqyrtues vlerëson se sasi të kërkuar nga AK-ja për pozicionet 20 dhe 21 që kanë të bëjnë me dorëza është në distreksion të AK-së të vendosur se sa janë të nevojshme sikurse parashihet në nenin 9 të LPP-së ngase AK-ja është përgjegjëse sipas nenin 4 të Rregullores për Prokurim Publik, andaj ky pretendim ankimor është i pa qëndrueshëm.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “013 Furnizim me barna dhe material shpenzues mjeksore per barnatoren qendrore pran QKMF-se për plotësimin e mungesave me furnizim nga lista esenciale” me numër të prokurimit 635-25-2045-1-1-1. AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas të gjeturave në këtë vendim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - MESE PHARM SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: